



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.805/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e votuesit nga komuna e Junikut, Valdrin Hoxha paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Valdrin Hoxha, votues nga komuna e Junikut ZL.Anr.805/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Valdrin Hoxha, votues nga komuna e Junikut, me të cilën pretendon se ka qenë asistues i gjyshës së tij Nurie Hoxha si votuese e kategoris së votuesve me kusht (VPNV) 31/01/01 dhe pas publikimit të rezultateve ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nuk iu ka dal vota e sajë apo nuk është numruar fare. Parashtruesi i apelit pretendon se kandidatin të cilin e ka votuar nuk e ka marrë asnjë votë me kusht. Kërkon nga PZAP-i që të bëhet hetimi për arësye të mungesës së votës së gjyshës së tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apeleve dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimit të apelit gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka identifikuar numrin e vendvotimit në të cilin ka votuar dhe me të cilën pretendon se i mungon vota me të cilën kanë votuar me kusht. Prandaj Paneli apelin e parashtruar nga personi i lartcekur e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi

që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.805/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*